

Kisha e “Shën Mitrit” në lagjen Kala në Berat, një tjetër monument i shpëtuar



Kishte vite që nuk shihte ndërhyrje, por tashmë kisha e “Shën Mitrit”, në lagjen Kala është një tjetër monument i shpëtuar.

Lajmi u bë i ditur nga ministrja e Kulturës, Elva Margariti, e cila thekson se “restaurimi/mirëmbajtja në kishën pasbizantine të shekullit XVII, në kalanë e Beratit, punimet e restaurimit në çatinë e monumentit, konsolidimi i mureve të oborrit, mbulimi me tjegulla i tyre, kanë rikthyer normalitetin, në këtë objekt të trashëgimisë”.

“Afresket me shumë vlera në brendinë e naosit dhe një pjesë e jashtme, nën strehen e restauruar, tashmë konsiderohen jashtë rrezikut të shkatërrimit”, tha Margariti.

Ministrja Margariti bëri të ditur se së shpejti nis një projekt i ri për konsolidimin dhe restaurimin e afreskeve të këtij monumenti të rëndësishëm.

Pak histori rreth monumentit...

Kisha e Shën Mitrit ndodhet në pjesën lindore të kalasë, midis shtëpive të banuara, dhe futet në tipin e kapelave të thjeshta pasbizantine. Pjesa e naosit në qendër më përpara qarkohej nga një hajat i vogël në krahun verior, perëndimor dhe jugor, ndërtim që i përkiste një periudhe më të vonë ndërtimi se vetë kisha.

Ambienti i kishës nga brenda është i shtruar me pllaka guri gëlqerori dhe shtufi të vendosur në mënyrë të çrregullt. Dikur naosi ndahej nga mjedisi altarit nëpërmjet një ikonostasi druri. Altari përbëhet nga absida gjysëm rrethore që nuk shkon deri në tokë me dy kamare katrore (nike) anash saj. Ndriçimi i sallës realizohet nëpërmjet një frigjie të vogël në murin e absidës dhe nga një baxha e hapur në çati. Hyrja për në sallën qendrore realizohet nëpërmjet dy dyerve, një në anën jugore dhe tjetra në anën perëndimore, kjo e fundit është ende një derë me dru origjinal nga faza e parë e ndërtimit.

Brendësia e naosit mbulohet në një pjesë të tij nga afreskë me motive biblike me skena me përmasa të vogla që i përshtatet dimensioneve të kishës. Gjithashtu me afresk është veshur edhe pjesa e jashtme e ambientit perëndimor. Mbi hyrjen jugore nga brenda ruhet ende mbishkrimi i cili daton ndërtimin e afreskut në vitin 1607. Të gjitha muret janë ndërtuar me gurë gëlqeror të lidhur me llaç balte. Nga një datim i mbetur në kontrafortin e mëvonshëm të ngritur në pjesën jugore mësojmë se kisha është meremetuar në vitin 1774.